



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 3132 / prot
2

Gramsh, më 24 /5 /2019

VENDIM

Nr. 45 - dt 24.05.2019

Për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale të njësive administrative dhe në institucionet vartëse të saj.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 24.05.2019, pasi mori në shqyrtim relacionin dhe p/vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkise "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale të njësive administrative dhe Institucioneve vartëse të saj", mbështetur në ligjin nr.9936 date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë ,i ndryshuar ,ligjin nr.10296 date 08.07.2010 "për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik "paragrafi 95 e në vazhdim ,ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore "neni 8,pika 2, neni 9 pika 1/1 germa "b" ,si dhe neni 54 i tij .

VENDOSI

- I. Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve sipas llogarive të mëposhtme :
- **Llogaria 214** (Mallra) **63.400** (Gjashtëdhjet e tremijë e katërqind) lekë.
 - **Llogaria 327** (Inventar i imët) **1363251.6** (Njëmiljon e treqind gjashtedhjetë e tre dyqinde pesedhjet e nje pik gjashtë mijë) lekë.
 - **Llogaria 218**(Inventar ekonomik ,mjete kryesore) **7051897.1**(Shtate million zero pesedhjetë e nje mije e teteqinde e nentedhjetë e shtate pike nje) leke
- Totali: 8478548.7**(Tetëmilion e katerqind e shtatedhjetë e tete mij e peseqinde e dyzete e tete pik shtate) lekë.

- II. Lista e materialeve që do të nxierren jashtë përdorimit është e pasqyruar bashkëlidhur këtij vendimi sipas emërimit ,njësisë matëse ,cmimit ,sasisë, vlerës dhe arsyes së daljes jashtë përdorimit për cdo material .
- III. Materialet e nxjerra jashtë përdorimit nga komisioni përkatës ,të asgjesohen nga komisioni i ngritur me urdhër të kryetarit.
- IV. Vlerat materiale të përcaktuara jashtëpërdorimit e që do të asgjesohen nga komisioni me specialistë përkatës ,të zbriten nga vlera e inventarit dhe të shkarkohen në kartelat e magazinës përkatëse dhe të bëhen hyrje për vlerë të mbetur për ato materiale që komisioni i gjykon të arsyeshme.
- V. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

Sekretari i Këshillit


Astrit Duzha



Konc.Dak.A.Duzha



Pranoi.Sh.Hoxha



Dosja__

Afati __

Ekzemp.__



Kryetari i Këshillit

Shkëlqim Hoxha

